



se i Dërguari i Allahut ﷺ ishte më i vërteti, vërtetësia e të cilit është dëshmuar, dhe thoshte: “Çdo njeriu i tubohet krijimi në mitrën e nënës së tij për dyzet ditë e dyzet net

Abdullah ibën Mesudi (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se i Dërguari i Allahut ﷺ ishte më i vërteti, vërtetësia e të cilit është dëshmuar, dhe thoshte: “Çdo njeriu i tubohet krijimi në mitrën e nënës së tij për dyzet ditë e dyzet net, pastaj, për po aq ditë shndërrohet në droçkë gjaku, më pas, për po aq ditë, shndërrohet në copë mishi (sikurse mishi i përtypur). Pastaj, atij i dërgohet një melek i urdhëruar me katër gjëra: të shkruajë furnizimin e tij, jetëgjatësinë, veprën, si dhe nëse do të jetë fatzi ose i lumtur (në botën tjetër). Më pas, i fryhet shpirti. Prej jush ka të atillë që, bën vepra të xhenetlinjve, madje aq sa vetëm një kut e ndan prej Xhenetit, por, ja që vjen në shprehje ajo që i është shkruar, kështu që punon vepra të banorëve të Zjarrit, rrjedhimisht hyn në të, dhe anasjelltas, ka të atillë që bën vepra të xhehenemlinjve, saqë mes tij dhe Zjarrit s’ka më shumë se një kut, por, ja që vjen në shprehje caktimi që i është ndarë, ndaj bën punë të banorëve të Xhenetit dhe hyn në të.”

[Sahih] [Muttefek alejhi]

Ibn Mesudi thoshte: "I Dërguari i Allahut ﷺ ishte më i vërteti, vërtetësia e të cilit është dëshmuar nga Allahu i Lartësuar: Ai ka thënë: "Çdo njeriu i tubohet krijimi, e kjo është kur burri kryen marrëdhënie me bashkëshorten e tij, ku sperma e tij e shpërndarë mblidhet në mitrën e gruas për dyzet ditë si copë e varur gjaku, më pas, në dyzetëshen e dytë, shndërrohet në copë mishi, pra, gjak i trashë e i fortë. e më pas shndërrohet në copë mishi, e cila është aq sa përtypet dhe kjo është dyzetëshja e tretë. Pastaj Allahu ia dërgon melekun, i cili i fryn shpirtin, pas përfundimit të dyzetëshes së tretë. Meleku urdhërohet të shkruajë katër gjëra: furnizimin e tij, respektivisht sasinë e begative që do të marrë gjatë jetës së tij; jetëgjatësinë, respektivisht periudhën se sa do të qëndrojë në këtë botë; veprën e tij, se çfarë do të bëjë dhe se a do të jetë i lumtur a fatzi (në botën tjetër). Pastaj Profeti ﷺ u betua se ndonjë njeri do të bëjë vepra të banorëve të Xhenetit dhe veprat e tij do të jenë të mira, pra, njerëzve u duken të tilla, si dhe do të vazhdojë kështu, derisa mes tij dhe Xhenetit të jetë vetëm sa një kut, që do të thotë: ajo që mbetet mes tij dhe arritjes në Xhenet është gjatësia e një kuti, por libri ia parakalon dhe ajo që është caktuar për të, kështu që bën vepra të banorëve të Zjarrit dhe në këtë gjendje përfundon dhe, si rrjedhojë, futet në Zjarr, sepse kusht që puna e tij të pranohet është që të jetë i qëndrueshëm në të dhe të mos ndryshojë. Ndërkaq, një njeri tjetër bën vepra të banorëve të Zjarrit, derisa të jetë afër hyrjes në të, saqë ajo që mbetet mes tij dhe arritjes në Zjarr është gjatësia e një kuti, por libri ia parakalon

dhe ajo që është caktuar për të, kështu që bën vepra të banorëve të Xhenetit dhe, si rrjedhojë, futet në Xhenet.

<https://sunnah.global/hadeeth/sq/show/65037>

النجاة الخيرية
ALNAJAT CHARITY

